



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2019:099349

Datë: 04.03.2021

Numri i dokumentit: 01567123

P.nr.72/19

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtari i vetëm Sadri Krasniqi, me sekretaren juridike Tevide Thaqi, në lëndën penale kundër të akuzuarve: A.I.dhe Q.R. që të dy nga, për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 parag. 1 nën parag. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.568/2019, të dt. 19.04.2019, më datë 18.02.2021, në prani të Prokurores së Shtetit Bahtie Ademi, të akuzuarve A.I. dhe Q.R., shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 03.03.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

T ë a k u z u a r i t :

1.A.I., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati R. dhe e ëma H., mbiemri i vajzërisë A., i lindur më, në ku edhe jeton,”, me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, e gjendjes së mesme ekonomike, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i akuzuari ka qenë i dënuar për vepër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

2. Q.R., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati H. dhe e ëma K., mbiemri i vajzërisë O., i lindur më, në, ku edhe jeton.....”, me nr. personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar, e gjendjes së varfër ekonomike, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë i akuzuari nuk ka qenë i dënuar për vepër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

J a n ë f a j t o r ë

Sepse,

Më datë 12.03.2019, rreth orës 05.00 min, në fshatin Berivojcë, Komuna e Kamenicës, në lokalin “.....”, të pandehurit në bashkëveprim pas një mosmarrëveshje me të dëmtuarin E.S. të njëjtit i kanë shkaktuar lëndime trupore në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte prezent në lokalin e lartë cekur, ku pronar është i pandehuri A., të njëjtit fillimisht e shërbejnë me alkool, pastaj duke e shfrytëzuar gjendjen e dehur të dëmtuarit, e hedhin jashtë lokalit, duke e goditur me grushte (boksa) e lënë të shtrirë në tokë të gjakosur, kur nga goditjet proteza e dhëmbëve dhe telefoni i mbesin në vendin e ngjarjes, i cili pastaj si pasojë e lëndimeve të pësuar trupore, detyrohet të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Rajonal në Gjiilan, sipas raportit mjekësor me nr. 6057 të datës 12.03.2019.

- me ç’rast kanë kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188, parag. 1 nën parag. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit të lartë cekur dhe neneve 4, 38, 43, 69, 70 dhe 71 KPRK-së, lidhur me nenin 365 dhe 451 të KPPRK-së, të akuzuarit i ,

G J Y K O N

Të akuzuari **A. I.**, me dënim gjobe (në të holla) në shumë prej **300 €** (treqind euro), ndërsa të akuzuarin **Q.R.**, me dënim gjobe (në të holla) në shumë prej **250 €** (dyqind e pesëdhjetë euro), të cilët dënime të njëjtit kanë për t’i arkëtuar në afatin prej 15 dite nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, në të kundërtën, të njëjtit dënime me gjobë do t’i zëvendësohen në dënime me burg, ashtu që për çdo 20 €, do t’i logaritet nga një ditë burg.

Pala e dëmtuar E.S. nga , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohen të akuzuarit A. I. dhe Q.R., që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 €, secili i akuzuar, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu të akuzuarit obligohen që në kuptim të nenit 39, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguajnë shumën prej nga 30 €, secili i akuzuar, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.568/2019, të dt. 19.04.2019, ka kërkuar që ndaj të akuzuarve: A.I. dhe Q.R. që të dy nga, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 188, parag. 1 nën parag. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarve për datë 11.09.2019, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, të akuzuarit A. I. dhe Q.R. kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen, njëherit theksojnë se nuk pranojnë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Pasi që të akuzuarit në afatin ligjor nuk i kanë kundërshtuar provat në aktakuzë dhe nuk kanë parashtruar kërkesë për hedhjen e aktakuzës, gjykata lidhur me rastin ka caktuar seancën për shqyrtimin kryesor për dt. 18.02.2021, në të cilën seancë gjyqësore, përkatësisht në fillim të seancës të akuzuarit kanë deklaruar se e pranojnë fajësinë për veprën penale që i vëhet në barrë sipas aktakuzës. Andaj pasi që të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë dhe veprën penale për të cilën ngarkohen sipas aktit akuzues, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuzë, por drejtëpërdrejtë është shkuar në fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit Bahtie Ademi në fjalën përfundimtare deklaron se mbetet pran aktit akuzues, njëherit thekson se pasi që të akuzuarit kanë pranuar fajësinë dhe veprën penale për të cilën ngarkohen sipas aktit akuzues, gjendja faktike është vërtetuar. Pranimi i fajësisë është në përputhshmëri edhe me provat e propozuara, por për shkak të pranimit të fajësisë ato nuk janë shtjelluar, i propozon gjykatës që të akuzuarit t'i shpalli fajtorë dhe me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësisë e dënimit, t'i ketë parasysh rrethanat si ato lehtësuese, njashtu edhe ato rënduese.

I akuzuari A.I. në fjalën përfundimtare deklaron se e pranon fajësinë për veprën penale, ka gabuar, andaj kërkon nga gjykata që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit, mundësisht t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

I akuzuari Q.R. në fjalën përfundimtare deklaroi se e pranon fajësin për veprën penale që i vëhet në barrë sipas aktit akuzues, ka gabuar dhe më nuk do të përsërisi veprime të tilla, andaj kërkon nga gjykata që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë dënimit të ketë parasysh gjendjen e tij të vështirë ekonomike, ngase si i pa punë jeton në kushte shumë të vështira ekonomike, nga ndihma sociale, që mundësisht t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Pas dëgjimit të palëve, gjykata ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se të akuzuarit A.I. dhe Q.R., me dashje ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 188, paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilën vepër penale, gjykata të akuzuarit i shpalli fajtor, ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën janë edhe penalisht përgjegjës.

Gjykata me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarve për veprën penale të kryer, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të neneve 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritort të dënimit ligjor. Në veçanti për këtë rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarit gjyqtari i vetëm gjykues pati parasysh pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, se janë penduar thellë për veprën penale të kryer, faktin se ndaj tyre nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, si dhe premtimin e tyre se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepër tjetër penale. Ndërsa për të akuzuarin Q.R. gjykata pati parasysh edhe gjendjen e tij të vështirë ekonomike, kurse për të akuzuarin A.I., si rrethë rënduese pati parasysh faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar për vepra penale, shih Aktgjykimet: PKR.nr.156/17, i plotfuqishëm më 30.10.2017, P.nr. 7 69/2019, i plotfuqishëm më 24.12.2019, P.nr.25/2018, i plotfuqishëm më 26.03.2019 etj.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimet me gjobë ndaj të akuzuarve A.I. dhe Q.R., duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarve.

Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Pala e dëmtuar E.S. nga, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarve, gjykata, bazuar në nenin 451 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarit t'i detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (Njëzetë euro), si dhe nga 30 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË KAMENICË,

P.nr.72/19 më datë. 03.03.2021

G j y q t a r i,

Sadri Krasniqi,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.